



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.07.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Petrit Vasili – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 02.07.2018.
2. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit.
3. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes se huas ndërmjet Republikës se Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale".

Marrin pjesë:

Petrit Vasili, Elisa Spiropali, Ilir Pendavinji, Klodiana Spahiu, Flamur Golemi, Edlira Bode, Arben Kamami, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, Nuri Belba, Floida Kërpaçi dhe Klotilda Bushka (*deputete zëvendësuese*).

Mungojnë:

Bardh Spahia, Adelina Rista, Vangjel Tavo, Grida Shqina, Halim Kosova, Orjola Pampuri dhe Lindita Metaliaj.

Të ftuar:

Bardhylka Kospiri – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Ekonomisë dhe Financave
Denada Seferi – Drejtoreshë Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Tedi Bushaj – specialist në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

HAPET MBLEDHJA

Petrit Vasili – Së pari, në mbledhjen e sotme kemi, pasi duhet ta bëjmë, miratimin formal të projektkalendarit, që lidhet me ditët e mbetura për mbylljen e këtij sesi. Ndërsa pikën e dytë menduam ta bashkojmë me të parën për t'i dhënë kohë vetes, por edhe për të bërë të mundur që stafi të përgatisë relacionin, pasi besoj se kjo marrëveshje mund të kalojë të enjten në seancë, prandaj në këtë draftkalendar janë propozuar të dyja bashkë. Në qoftë se ka ndonjë vërejtje nga kolegët për këtë draftkalendar, le ta bëjë, në rast të kundërt, ta konsiderojmë të miratuar.

Ka ndonjë sugjerim apo vërejtje për projektkalendarin? Jemi dakord?

Dakord.

Atëherë, meqenëse jemi dakord, le të fillojmë me shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale”. Lidhur me këtë projektligj ne kemi komunikuar dhe kam kënaqësinë që prezente kemi dy zëvendësministret, zonjat Bardhylka Kospiri dhe Dajna Sorensen. Mirë se keni ardhur në komision! Gjithashtu kemi edhe zonjën Denada Seferi dhe zotin Tedi Bushaj, përkatësisht nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, pasi projektligji është propozuar dhe vjen në Kuvend me nismën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, por zbatuesja e drejtpërdrejtë dhe e vetme e kësaj marrëveshjeje është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Kalojmë pa humbur kohë në shqyrtimin e këtij akti.

Kush do të donte ta merrte fjalën nga të dyja zëvendësministret e ftuara, sipas preferencës, për të bërë një paraqitje shumë të shkurtër ose dy-tre objektivat që ky projektligj synon të realizojë apo edhe ndonjë gjë tjetër, që ju doni ta nënvizoni më shumë në këtë pjesë të shqyrtimit?

Jemi në etapën e shqyrtimit në parim të projektligjit, për të vijuar më pas me shqyrtimin nën për nen.

Kush e do fjalën nga ju?

Po, zonja Sorensen.

Dajna Sorensen – Po filloj unë dhe pastaj ia kaloj fjalën znj. Kospiri.

Përshëndetje, zoti kryetar!

Përshëndetje të gjithëve!

Sikurse ju e përmendët, projektakti në fjalë ka të bëjë me shtimin e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale nëpërmjet akordimit të një huaje shtesë prej 11 milionë dollarësh. Projekti në vetvete synon të mbështesë reformën e programeve të ndihmës sociale në Shqipëri dhe janë dy objektiva primarë, të cilët synohet të arrihen.

Objektivi i parë ka të bëjë me mbështetjen e zbatimit të përmirësuar të programit të ndihmës ekonomike dhe atë të programit të aftësisë së kufizuar.

Objektivi i dytë ka të bëjë me mbështetjen e kapaciteteve për zbatimin dhe përmirësimin e programeve në përgjithësi të mbështetjes sociale.

Pa dashur të futem tek elementet teknike, që i përkasin Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dua të nënvizoj vetëm një element, që për sa i përket huas së akorduar, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, ajo është në vlerën 11 milionë dollarë dhe kushtet e përfshira në këtë aktmarrëveshje janë kushtet tipike standarde të Bankës Botërore. Kështu që në vetvete ato nuk përbëjnë ndonjë diferencë nga marrëveshje të tjera.

Për sa u përket elementeve teknike, po ia kaloj fjalën zonjës Kospiri.

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Sorrensen!

Urdhëroni, zonja Kospiri!

Bardhylka Kospiri – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zonja e zotërinj deputetë,

Sot paraqitet për miratim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e financimit për projektin për modernizimin e asistencës sociale”, i cili ka për qëllim financimin shtesë për projektin e modernizimit të asistencës sociale, nëpërmjet të cilit do të sigurohet mbështetja për të siguruar shtrirjen graduale kombëtare të reformës së aftësisë së kufizuar, si dhe vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e reformave për kriteret e përshtatshmërisë për reformën e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, gjithashtu zhvillimin e një strategjie daljeje dhe një planveprimi për të mbështetur përfituesit e ndihmës ekonomike që dalin nga programi i ndihmës ekonomike.

Miratimi i marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ka si objektiv përmirësimin e mëtejshëm të barazisë dhe efikasitetit të sistemit të asistencës sociale.

Duke u bazuar në përmirësimin e barazisë, kjo pritet të arrihet nëpërmjet zbatimit të kriterëve të reja për përcaktimin e aftësisë së kufizuar në bazë të modelit social për të paktën gjysmën e popullsisë së vendit; së dyti, për përmirësimin e aksesit të personave me aftësi të

kufizuar në zyrat rajonale të shërbimeve sociale shtetërore, ku merren edhe vendimet përfundimtare për aftësinë e kufizuar; së treti, për harmonizimin e kriterëve të vlerësimit dhe përshtatshmërisë për të dyja përfitimet (ato pa kompensim dhe ato kontributive të aftësisë së kufizuar) dhe, së katërti, për promovimin e përfshirjes sociale të ndihmës ekonomike në periudhën e tranzicionit dhe daljen nga programi i asistencës së ndihmës ekonomike me pagesë.

Për sa i përket efikasitetit, pritet të arrihet, nëpërmjet hartimit dhe përdorimit të raporteve të gjeneruara nga sistemi i menaxhimit të informacionit të automatizuar, menaxhimi i performancës së programit të asistencës për aftësinë e kufizuar, gjithashtu përmirësimi i mbikëqyrjes dhe kontrollit të përfitimeve nga programi i asistencës për aftësinë e kufizuar.

Monitorimi i zbatimit të këtyre objektivave të projektit dhe reformave të ndërmarra do të bëhet nëpërmjet realizimit të indikatorëve, që lidhen me disbursimin dhe që janë katër që, kuptohet, për rrjedhojë, plotësimi i këtyre katër indikatorëve do të sjellë edhe disbursimin e fondeve, që tashmë janë të parashikuara në këtë marrëveshje.

Ky ishte një prezantim në terma të përgjithshëm.

Faleminderit për vëmendjen!

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Kospiri!

Ka ndonjë gjë për të shtuar nga të ftuarit e tjerë të stafeve respektive?

Në rast se nuk ka, vazhdojmë me pyetje nga kolegët.

Kush ka pyetje ose diskutime lidhur me këtë moment të shqyrtimit në parim?

Meqenëse nuk shoh që kolegët të kenë pyetje, unë kam disa pyetje për të sqaruar më tepër thelbin, pasi, që të biem dakord, edhe memoja shoqëruese, me thënë të drejtën, është shumë e thatë dhe na ndihmon shumë pak për të kuptuar se çfarë ne miratojmë sot.

Së pari, pas një projekti fillestar dhe një huaje fillestare prej 38 milionë eurosh, kërkohet sot, ne jemi këtu për ta miratuar, edhe një shtesë prej 11 milionë dollarësh. Pyetja ime e parë është: kjo shtesë vjen sepse parashikimet në projektin bazë nuk qenë adekuate, doli një problematikë e re, apo çfarë gjëje e jashtëzakonshme doli që kërkoni një shtesë, e cila, që të jemi objektivë, nuk është e vogël, pasi projekti bazik ka qenë 38 milionë, dhe një shtesë prej 11 milionësh nuk është e vogël, pra nuk është një shtesë e parëndësishme?

Tani, një ndër katër objektivat më të spikatur, ku do të përqendrohet më së shumti kjo shtesë e re, prej 11 milionë dollarësh, është rishikimi i parametrave të programeve të ndihmës sociale.

Pyetja e dytë, për sa i takon kësaj katërsheje, parametrat themelorë të programit të ndihmës sociale janë përcaktuar shumë qartë edhe në strategjinë 2015-2020 “Përkrahje

sociale”, e miratuar dhe e cila është bërë bashkë me mbështetjen e UNICEF-it, në mos gabo, edhe të ambasadës zvicerane.

Çështja e parametrave, së paku, me gjithë 38 milionë eurot e shpenzuara më parë, duhet të ishte zgjidhur në parim dhe më tutje, sigurisht, gjatë implementimit mund të dalin edhe çështje të reja që kërkojnë shtesa, por kjo është premisa themelore mbi të cilën merret një program, që synon të ndryshojë ndihmën.

Së dyti, po këtu, një objektivi tjetër është për të mbështetur një strategji novatore dhe për të mbështetur nevojat ndërkombëtare për daljen e përfituesve të ndihmës ekonomike dhe integritit të tyre në skemat aktive. Edhe për këtë çështje jo vetëm që ka shprehje, por ka edhe dokumente fort të rëndësishme, miratuar së fundi, qoftë nga ish-Ministria e Punës, ku është edhe strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi, si dhe strategjia kombëtare për mbrojtjen sociale, që datojnë në periudhën 2015-2020. Pra, jemi mu në zemër të objektivave, të cilët tani kanë implementimin. Ndërsa pjesën e miratimit të këtyre parimeve, inovacioni që duhej të përdorej për të pasur këto gjëra, i kemi në dokumentet bazike, që janë tashmë publike dhe janë miratuar nga po e njëjta ministri, e cila, sigurisht, ka vijimësinë e saj, pavarësisht nga mënyra e organizimit.

Duket paksa e çuditshme që në momentin kur programi synon të ketë një implementim sa më të madh, normalisht për këtë i merr paratë shtesë, nuk mund të vijë në pjesën e fillimit të tij, që të bëjë parametra dhe të përcaktojë strategji.

Së treti, thotë: “Përgatitjen e një politike të rishikuar për sanksionet dhe hartimin e instrumenteve për zbulimin e mashtrimeve, gabimeve, mekanizmave të tjerë të inspektimit social”. Por ne kemi pasur mundësi këtu të dëgjojmë, edhe me rastin e debatit të çështjes së personave që dalin nga skema e të tjerë, ku ishin përcaktuar edhe formulat, edhe programi përkatës, si dhe të gjithë mekanizmat konkretë, që tashmë e kishin filluar implementimin.

Tani, të kthehem përsëri dhe të themi se ne do të jemi këtu? Në parim mund të ishin objektiva të logjikshëm në momentin e marrjes së kësaj huaje, por këtu duhej të dilnin probleme që lidhen logjikisht drejtpërdrejt me implementimin, që ka rezultuar me problem këtu, këtu dhe këtu. Këto mekanizma implementuese duhen parë, por duhen edhe disa para për t’i mbështetur.

Së fundi, ka edhe një tjetër objektivi, ku thuhet: “Nxitjen e transparencës në komunikim, monitorim e vlerësim, si dhe angazhimin e qytetarëve në këtë proces”. Nuk kam asnjë rezervë për këtë punë, por e formuluar në këtë mënyrë kaq grosolane, pra me kaq përgjithësi, pa asnjë element konkret... Asnjëri nga ne nuk është kundër që për një sektor kaq delikat të mos ketë

mbështetje, por me këto shpjegime kaq flu, ku nuk ka asnjë detajim, ku thua: “nxitje e transparencës në komunikim, monitorim e vlerësim dhe në angazhimin e qytetarëve”, këto ishin premisat themelore që kur filloi procesi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur është bërë strategjia, kush e ka lexuar me vëmendje, unë e kam pasur durimin, sepse janë dokumente zyrtare shumë të rëndësishme, ndër elementet thelbësore që ka strategjia janë: monitorimi, vlerësimi dhe transparenca në komunikim, e cila përmirësohej në themel në strategjinë e re. Angazhimi i qytetarëve është parashikuar dhe ka kapituj më vete.

Tani, ju mund t’i keni shumë kthjellëta për veten tuaj, unë nuk e diskutoj se i keni, por kjo paraqitje e aktit, është vendi për ta thënë edhe një herë tjetër, për t’ia transmetuar edhe qeverisë, kur vjen në mënyrë të veçantë çështja për marrëveshje, pra hua, para që marrin borxh, detajimi i tyre duhet të jetë i plotë në memon që shoqëron qeverinë, pasi, po e them edhe një herë tjetër, me këta katër tregues do të thotë se jemi në fillimin e implementimit të një marrëveshjeje, jo në përfundimin e së parës dhe kërkimit të një shtese të re.

Megjithatë, unë jam i gatshëm të dëgjoj edhe çfarë shpjegimi mund të keni për këto pika.

Bardhylka Kospiri – Faleminderit, zoti kryetar!

Në vijim, bashkë me kolegen Seferi do të përgjigjemi për të gjitha problematikat dhe shqetësimet që ju ngritët, duke i marrë një nga një.

Po filloj me të parën.

Lidhur me pyetjen se pse është i nevojshëm ky financim shtesë, është e vërtetë se projekti është dizenuar në vitin 2010 dhe është miratuar në vitin 2012. Për sa i përket hapësirës që zinte vëmendja ndaj reformës së ndihmës ekonomike në raport me reformën e aftësisë së kufizuar, le të themi se i ishte lënë një hapësirë shumë e ngushtë pjesës së aftësisë së kufizuar. Kështu që u gjykua se kjo duhet trajtuar më gjerë. Madje vetë fillimi, pas trajtimit të pjesës së ndihmës ekonomike, i reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar nxori problematika në vazhdim. Kështu që, për atë hapësirë mbështetja që ishte dhënë nga kredia ishte e pamjaftueshme për të vazhduar më tej me reformën.

Duke pasur parasysh se është një reformë delikate, një reformë që kërkon shumë vëmendje, madje është edhe më e ndërlikuar se reforma e ndihmës ekonomike, nga vetë rezultatet e kësaj kohe (gjatë periudhës së dizenjimit dhe pilotimit të reformës së aftësisë së kufizuar) u kërkua dhe u gjykua se kishte nevojë edhe për disa hapa të tjerë për ta konsoliduar më tej këtë reformë dhe për ta çuar në shtrirjen e saj.

Edhe për sa i përket reformës së ndihmës ekonomike, është e vërtetë se, ndër të tjera, ka pasur vëmendje dhe ka zënë hapësirën e saj kalimi nga pjesa e ndihmës ekonomike drejt integritit për punësim apo në përfshirjen e niveleve të tjera të familjeve, që kanë qenë përfituese nga ndihma ekonomike, por kanë qenë të pamjaftueshme. Tani është gjykuar se do të ketë një strategji të veçantë për të gjithë ata përfitues ose mospërfitues nga reforma e ndihmës ekonomike, por do të orientohen për integrim social në mënyrën e duhur dhe në vendet e duhura. Këto i kemi marrë sipas modeleve që kanë sjellë edhe ekspertizat, edhe ekspertët ndërkombëtarë. Madje ekspertët e Bankës Botërore të kjo pjesë kanë qenë të vëmendshëm, që ne duhet të ecim në rrugën e disa eksperiencave të mëparshme që ato kanë pasur në të njëjtat situata në vendet e tjera.

Lidhur me reformën e personave me aftësi të kufizuar, është e vërtetë se kur reforma u dizenjua në fillim kishte një spektër më të ngushtë lidhur me vlerësimin e personave me aftësi të kufizuar, por, edhe në konsulencë me Bankën Botërore, edhe me eksperiencat e sjella nga OBSH-ja, u përcaktua që kjo reformë duhet të fillonte dhe filloi siç është detyrim i disa, le të themi, objektivave të shprehura edhe nga Banka Botërore, që nuk ishte thjesht një reformë vlerësimi, siç ka qenë deri tani, thjesht mbi bazë mjekësore, por të ishte një reformë vlerësimi në konceptin biopsikosocial, që ka të bëjë me ICF-në. Pra, synohet që personave me aftësi të kufizuar, të rivlerësoar, t'u mundësohet të kenë shërbime më konkrete, sepse kjo reformë ka disa etapa: të integrohen, ata që duan dhe që mund të integrohen, domethënë jo thjesht të jenë përfitues pasivë nga ato skema që ofrojnë sot mbështetje thjesht në para.

Lidhur me nxitjen e transparencës, kjo ka të bëjë edhe me fushat e komunikimit. Pra, jo se nuk është punuar, domethënë nuk është ajo që ne rikthehemi pas, në hapat e parë, por vetë zhvillimet, edhe në pjesën e reformës së ndihmës ekonomike gjatë pilotimit dhe të shtrirjes së saj të mëtejshme, që bëme në të gjithë vendin, po ashtu edhe gjatë pilotimit të reformës për vlerësimin e aftësisë së kufizuar, u pa e domosdoshme që pjesa e komunikimit me publikun për të gjitha detajet e reformës, për të gjitha arritjet e kohës së reformës, si dhe për përmirësimet e mëtejshme që janë të nevojshme të bëhen të kihej më shumë në vëmendje.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Po, zonja Spiropali.

Elisa Spiropali – Përshëndetje!

Faleminderit për prezantimin!

Në kujtesën time, kur ne bëme një dëgjese këtu në janar ose të paktën u prezantua marrëveshja për modernizimin e skemës, u premtua që ne mund të bënim një dëgjese bashkë,

për sa u përket progresit që është bërë dhe arritjeve që ka pasur skema e re ose e rezultateve, sfidave të skemës. Unë mendoj se ndoshta ka ardhur koha që në shtator të kemi një raport të detajuar të progresit të skemës të modernizimit të ndihmës ekonomike dhe asistencës sociale në tërësi, duke qenë se, si deputetë, ne kemi ndjeshmëri të lartë për sa u përket problemeve që ngrihen në territor.

Duke qenë se unë mbuloj edhe pjesën e bashkëqeverisjes, e di se aty vijnë shumë ankesa individuale për sa i përket skemës, disa vijnë nga moskuptimi, disa të tjerë nga problemet që kanë me administratën lokale, ndërkohë që disa ankesa të tjera janë flagrante që, në opinionin tim, janë padrejtësi. Pra, ata janë hequr padrejtësisht nga skema. Arsyet le t'i gjejmë në vazhdim.

Do të ishte mirë që në shtator, ne do t'ju bëjmë thirrje, unë i kërkoj edhe komisionit këtu, që të bëjmë një dëgjese për sa i përket progresit të deritanishëm të skemës dhe të sfidave në vazhdim.

Gjithashtu, nëse mund të na bëni një shpjegim dyminutësh se si mendoni, në opinionin tuaj, ka shkuar procesi i implementimit të skemës së ndihmës ekonomike dhe asistencës sociale.

Faleminderit!

Bardhylka Kospiri – Faleminderit, zonja Spiropali!

E presim me shumë kënaqësi këtë ftesë, që në shtator ne të jemi para jush për të bërë një prezantim të arritjeve, pa diskutim edhe të sfidave, pasi ka edhe sfida për të kaluar, sepse do të kemi nevojë edhe për mbështetje të mëtejshme, pra duhet të kemi ndoshta edhe ndryshime ligjore, që duhet të ecim më tej për të sanksionuar dhe për të bërë realisht prezente ato rezultate që deri tani kanë sjellë pilotimin dhe që është e detyrueshme të kemi disa ndryshime ligjore për të thënë në fund se kjo skemë funksionon vërtet dhe se duhet të funksionojë në këtë mënyrë.

Ajo që është shumë e rëndësishme, lidhur me vlerësimin e aftësisë së kufizuar, është fakti se personat me aftësi të kufizuar vlerësohen rast pas rasti, vlerësohen me dinjitet para një komisioni të specializuar, pra para një zyre të specializuar, marrin orientimin për shërbime të nevojshme. Kjo do të nxisë edhe mirëmenaxhimin e shërbimeve ekzistuese, por, njëkohësisht, edhe nismën për të shkuar më tej për të ngritur shërbime të reja të munguara. Për këtë ne kemi nevojë shumë për t'u mbështetur në vazhdim, sepse kuptohet do të ketë edhe nevoja financiare. Por, përtej kësaj, ajo që është më shumë arritje e kësaj reforme ka të bëjë me faktin se do të flasim me persona me aftësi të kufizuar që do të shkojnë drejt punësimit që, ashtu si te skema e ndihmës ekonomike, do të orientohen zyrat e punës, me të cilat po ndërtojmë marrëveshje,

ku do të kemi të njëjtën situatë, ku persona të dedikuar pranë zyrave të punës do të ndërmjetësojnë apo do të ngrenë mekanizma dhe metodologjinë se si personat me aftësi të kufizuar duhet të mbështeten dhe të ndihmohen nga punëdhënësi, sipas të gjitha modeleve ndërkombëtare, për të qenë produktivë në një proces ku ata mundet dhe duhet të jenë pjesë, si dhe të dalin nga skemat ku janë sot pasive, duke i lënë mundësinë që ata të cilët janë vërtet në gjendje të rëndë dhe ata që vërtet nuk mund të punësohen apo të bëjnë jetë shumë aktive, të mbështeten për të qenë në dinjitetin e tyre, të vlerësuar nga shoqëria dhe të mund të bëjnë një jetë sa më afër normales. Kjo do të çojë në ngritjen e shërbimeve të reja, njëkohësisht në diferencim pagesash edhe për ata që janë më rëndë dhe që kanë nevojë për shërbime sociale, shëndetësore e të tjerë. Ky është në thelbin e kësaj.

Pastaj, përtej kësaj kemi atë që kjo reformë tashmë ka një sistem të dixhitalizuar, pra është shumë transparente, që gjatë rrugës do të na shmangë abuzimet që bëhen deri tani, nuk është se nuk ka pasur abuzime. Ky sistem është elektronik dhe ka hapësirën ku çdo gjë mund të verifikohet në moment, ashtu siç po ndodh edhe aktualisht.

Këto janë përpjekjet që po bëjmë drejt përmirësimit të sistemit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar.

Petrit Vasili - Faleminderit, zonja Kospiri!

Gjithsesi, në vijim të pyetjeve që bëra, kam edhe 2-3 komente shumë të shkurtra.

Së pari, objektivat e përcaktuara për këtë hua me 11 milionë dollarë shtesë, të cilat sigurisht, në parim kanë një dakordësi nga të gjithë nga ne, por jam i detyruar t'ju them hapur se mënyra se si janë harruar këto objektiva dhe mënyra se si i prezantoni ju, janë një prezantim i përgjithshëm, i cili këtyre 11-12 grave dhe burrave që ndodhen këtu, që do ta votojnë së bashku këtë, pasi të dalin që këtej, nuk do të dinë se çfarë t'u thonë atyre që janë jashtë, se për çfarë do të përdoren konkretisht këta 11 milionë dollarë. Këtë ju them me bindje të plotë dhe i sfidoj në kuptimin pozitiv të fjalës, në kuptimin më të mirë, kolegët. E miratuam këtë 10-milionësh, sepse për 1-2-3-4 gjëra konkrete na duheshin këto para shtesë dhe i morëm për këtë qëllim, sepse nuk na prisnin punët.

Që t'u themi qytetarëve se te kjo pikë e marrëveshjes (u detyrova të merrem me marrëveshjen se nuk merrem dot më me relacionin, sepse ai është e varfër), se vazhdojmë të japim para, pasi kemi dhënë 38 milionë dollarë, të marrim edhe 11 milionë dollarë të tjerë dhe të themi se janë për shfrytëzimin e shërbimeve të konsultimit dhe për të rritur njohuritë teknike të ministrisë në fushat përkatëse, duke përfshirë edhe vlerësimin e përditshëm të projektit, prokurimin dhe menaxhimin financiar.

Të gjithë këtu kanë një eksperiencë shumë të gjatë në punët e shtetit, por të bëjmë një marrëveshje shtesë, se kemi hallin se si është vlerësimi i përditshëm i projektit?! Po kjo punë është zgjidhur që kur projekti është marrë. Janë përdorur 38 milionë dollarë dhe kjo nuk është zgjidhur me paratë shtesë. Ky është një nga objektivat e projektit.

Është një instrument, por nuk mund të jetë instrument thelbësor zhvillimi i një ankete vlerësuese për të parë sa të kënaqur janë me reformën. Ky është një nga shumë elementet vlerësuese të projektit, por nuk mund të jetë një nga objektivat themelore të projektit, sepse projekti nuk synon këtë.

Së treti, një objektiv tjetër është përgatitja e një politike të rishikuar për sanksionet dhe mekanizmat. Po sanksionet dhe mekanizmat u parashikuan që në çastin, kur ne morëm përsipër të implementojmë një reformë të re dhe e vetmja gjë që është thënë publikisht, është se gabimet që janë bërë gjatë rrugës dhe që kanë të bëjnë edhe me gabime të sistemit, gjë që është normale se po aplikojmë një sistem i ri, ishin plotësisht të korigjueshme, por kjo nuk do të thotë se do të jetë një politikë e re e rishikuar. Politikë e re është ajo që u miratua pak muaj më parë. Mund të ketë instrumente të caktuara implementuese, të cilat nuk funksionuan mirë dhe duhet të përmirësohen.

Edhe përgatitja e një strategjie daljeje për përfituesit, por që nga momenti që u mendua dalja nga skema, këtu është thënë, se është shumë e qartë (për këtë ka edhe dokumente të shkruara mirë), të cilat kishin parashikuar edhe strategjinë e daljes.

Unë po ju them se unë do ta votoj personalisht, por jam shumë zemërtër për mënyrën se si prezantohen këto. Ju them përsëri se të gjitha gjërat që kanë të bëjnë me këtë aspekt të jetës shoqërore dhe politike, personalisht do të isha shumë i motivuar t'i mbroja. Ju them sinjorisht, por për këtë shtesë nuk jam i zoti personalisht të them se përse do të përdoren konkretisht këto para.

Jua them se të shkruara kështu, janë objektiva të fillimit të një marrëveshjeje të madhe, atëherë kur është marrë 38 milionë dollarët, jo tani. Këtu, për komisionin do të ishin që Ministria e Shëndetësisë më shumë, se kuptohet që Ministria e Ekonomisë ka pasur të tutelimin e kushteve etj. dhe në këtë rast ajo është një aktor burokratik, por nuk është aktor thelbësor në implementim, do të thoshte se parashikohet që të trajtohet problematika e kaq mijëra njerëzve, që u kanë dalë këto probleme nga analiza që kanë bërë, prandaj marrim para shtesë. Ky grup ka nevojë për këtë gjë dhe për këtë duhet ngritur edhe kjo infrastrukturë mbështetëse, që ta mbështesë trajtë në formën e filluar. Pa këto tabela nuk është i plotë.

Merreni votën tonë! Jua japim me kënaqësi, por ky nuk është niveli i duhur i prezantimit.

Këtë kisha për t'ju thënë shumë miqësisht.

Edhe një herë tjetër, po ju them paraprakisht se të gjitha nismat që do të shqyrtojmë së bashku në mënyrë të veçantë, huatë, kreditë dhe marrëveshjet, t'i përgatisni që më parë tabelat e caktuara për këtë punë, pasi nuk do ta lejoj të vazhdojë shqyrtimi, nëse deputetët nuk e kanë të qartë. Çdo deputet merr vendim personal, por duhet të ketë në tryezë materialin që të thotë se përse përdoren paratë.

Në fund të ditës, do të thotë një kredi që nuk është e vogël, se 38 plus 11 i thonë 50 milionë dollarë dhe për këtë fuqi që ka shteti ynë, 50 milionë dollarë nuk është shifër e vogël. Vetëm për këtë desha t'ju tërhiqja vëmendjen me shumë mirëkuptim dhe me shumë dashamirësi.

A ka ndonjë koment tjetër shtesë? Nuk ka.

Patjetër. Urdhëroni, me kënaqësi!

Unë ju ftova edhe më parë.

Denada Seferi – Nëse më lejoni të sqaroj teknikisht. Kjo marrëveshje është quajtur financim shtesë, sepse është në vazhdimësi të implementimit të dy programeve, ndihmës ekonomike dhe të PAK-ut, por në të vërtetë është thellimi apo dizenjimi akoma më shumë i reformës për trajtimin e personave me aftësi të kufizuar.

Kur është dizenuar në vitin 2010 (ne kemi qenë dëshmitarë), ishte e pamundur që të arrinim të kuptonim se si do të shkonim deri te reforma e aftësisë së kufizuar, sepse presioni, trysnitë e grupeve të interesit kanë qenë shumë të mëdha. Të gjithë kemi qenë në tryezë dhe i kemi ditur. Secili grup kërkonte të mbronte kategorinë e caktuar të aftësisë së kufizuar. Kështu që, BB që atëherë, në marrëveshjen e kredisë fillestare vendosi të merrej vetëm një komponent shumë i vogël për aftësinë e kufizuar. Pra, të mos kishim një dizenjim të mirëfilltë të reformës, por të bënim thjesht një minireformë, pa i dizenuar të gjithë parametrat, transparencën etj, si të thuash, të gjitha detajet e kësaj reforme. U mor tërësisht me pjesën e ndihmës ekonomike, por pa dalë në një përfundim, në një strategji të veçantë për të cilën ndihma ekonomike përtej viteve 2018 dhe 2020 duhet të kishte implementim në terren. Ne bëmë realizimin dhe implementimin e ndihmës ekonomike nga janari deri sot, që është 6-mujori i parë dhe ne do të relatojmë për këtë, por në mënyrë të mirëfilltë të gjithë ekspertët, që erdhën në misionin e fundit në mars, vendosën unanimisht që ne duhet të mbështetemi në një strategji daljeje për ndihmën ekonomike. Strategjia e daljes përtej komponentit të punësimit, që ishte frytdhënës

në momentet e para, në të cilat u realizuan, përtej formimit profesional, kishte nevojë të ndërmerre 2-3 modele të tjera, të cilat duhet të jenë shumë të rëndësishme për furnizimin dhe qëndrueshmërinë e skemës së ndihmës ekonomike. Pra, të kemi një skemë ndihme ekonomike, ku më të varfrit të bëjnë pjesë në të, por brenda një afati 5-vjeçar duhen dizenuar të gjithë instrumentet dhe mekanizmat në mënyrë që ata të dalin nga kjo skemë e varfërisë.

Ndërkohë, për aftësinë e kufizuar, ne kemi pilotuar vetëm dy njësi shumë të vogla. Financimi shtesë do të shërbejë që të detyrojë edhe qeverinë shqiptare të ngrejë zyrat e vlerësimit, të trajnojë personelin, të ketë personel të mirëfilltë, se deri sot kemi vetëm mjekë, ndërkohë që nuk na duhen vetëm mjekë, por na duhen punonjës socialë dhe psikologë, të cilët realisht duhet t'i drejtojnë këta persona me aftësi të kufizuar, sepse gjëja më kryesore e kësaj reforme është ndarja sipas funksionaliteteve të nevojave të një personi e kategorisë së aftësisë së kufizuar. Pra, nuk thuhet më se Denada Seferi është person me aftësi të kufizuar dhe nëpërmjet KMCAP-it merr vendimin, por ky staf i ri i vlerësimit të aftësisë së kufizuar për të cilin BB-ja po jep mbështetje me një hua ndaj qeverisë shqiptare, thotë se jo vetëm do të trajnohen, por duhet të jenë punonjës socialë dhe psikologë, plus mjekë të dedikuar dhe jo më të vendosur nëpër zyra rajonale, por të jenë të punësuar veçanërisht për njësinë e vlerësimit të nevojave, të ndarë sipas kategorive, ku ai person, i cili është në kategorinë më të lehtësuar, të shkojë të punësohet dhe të mos marrë para nga buxheti i shtetit dhe ai person që është invalid më i thellë dhe nuk do të ketë më rikuperim në jetën e tij, do të marrë një pagesë të përcaktuar për sa i përket aftësisë së kufizuar dhe njëkohësisht, edhe për pjesën e kujdestarisë, edhe për detyrimet që janë vënë.

Zoti kryetar,

Ne kemi rishikuar kriteret mjekësore, por kemi shumë nevojë që të shkojmë përtej këtyre kriterëve mjekësore, pra të dizenojmë një sistem, i cili duhet të jetë thellësisht i reformuar për sa i përket aftësisë së kufizuar. Nëse nuk e çojmë drejt punësimit apo drejt formimit profesional, e kemi të pamundur të ecim.

Meqë te pjesa e parë e marrëveshjes nuk ishte e dizenuar fare në këtë këndvështrim, jua thashë se quhet financim shtesë, por në të vërtetë është një financim nga fillimi, pikërisht vetëm për aftësinë e kufizuar. Është një komponent për të cilin BB-ja mendoj se ne duhet të kishim një mbështetje më të plotë dhe më të thellë për sa i përket strategjisë së daljes për skemën e ndihmës ekonomike.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Denada,

Unë e mbylla diskutimin dhe ti deshe ta hapësh. Jam shumë i lumtur për këtë.

Pyetja është kjo: Kur dilet nga kjo sallë kryesorja është se çfarë raportesh kanë këto para? Hartimi i dokumenteve strategjike, implementimi konkret dhe pjesa e asistencës teknike.

Asnjë nga ne që jemi këtu (pa pasur ndonjë dashakeqësi), nuk e thotë dot këtë gjë.

Unë nuk e them dot. Nëse ka ndonjë koleg, që di ta thotë, unë jam i lumtur dhe e dëgjoj me kënaqësi. Tani pa e thënë këtë gjë, nuk bëhemi dot avokatët tuaj në këtë rast, sepse për aftësinë e kufizuar, absolutisht janë të gjithë bashkë, për aq sa delikat dhe i ndjeshëm është problemi.

Pyetja konkrete është kjo: këtu brenda ka hartim dokumentesh. Bashkangjitur do të ketë edhe hartim legjislacioni, se nuk mund të ndodhë ndryshe. Natyrshëm, ajo qasje e re do të kërkojë edhe ndryshime. Cila është pjesa ku do të merremi me letrat? Cila është pjesa ku do të merremi me ndihmën ekonomike, se e keni përmendur edhe këtë? Nuk është paraqitur që kjo shumë 11 milionë dollarë shkon vetëm për aftësinë e kufizuar në dokumentet e shkruara. Nëse nuk janë shkruar mirë, detyra është për ju, nuk është për ne. Cila është pjesa e asistencës teknike?

Duke i pasur këto gjëra ne themi me fjalët më të thjeshta se ne e kemi detyrë për ta thënë: aftësia e kufizuar ishte trajtuar në mënyrë të kufizuar deri në këtë çështje, prandaj u akorduan këto para në mënyrë që një person me aftësi të kufizuar nesër, do të ketë falë një strategjie të re, këtë mundësi.

Kë do të prekë kjo gjë? Do të prekë 3-4-5 mijë njerëz përfitues, që do të thotë se kjo reformë u takon këtyre njerëzve.

Cila është pjesa parazite (asistenca teknike)? Ne nuk e dimë sa është, por do të themi se është minimale, aq sa duhet për të vënë në funksionim projektin.

Të thëna kështu *flu*, kjo është si paraqitja e objektivave themelore që ka një program politik në fushën e asistencës sociale, apo të politikave të punës dhe të integritit social.

Kështu që, unë them të mbetemi me kaq në këtë diskutim. Le të jetë ky një sugjerim për një herë tjetër, sepse na hyn në punë të tërëve. Edhe kur të bëjmë dëgjues në shtator për këtë çështje, gjë që do ta bëjmë me kënaqësi, ju sot keni një avantazh shumë të madh se kur të vini nuk ballafaqohemi dot me ju, sepse ju jeni shumë rehat se nuk na keni dhënë ndonjë shifër këtu dhe çfarëdo që të thoni, do t'ju themi, po. Po të thoshit se kaq ka qenë kjo, ky komponent si u realizua, ne kishim ndërmend të bënim pyetje dhe dëgjesa do të ishte interaktive. Edhe ju na informoni ne, por edhe ne ju ndihmonim juve me ndonjë sugjerim.

Megjithatë, ju thamë ta rishikoni këtë gjë, sepse me të dalë nga kjo dhe nga seanca përkatëse plenare, ku kjo do të miratohet, do t'ju duhet ta mbroni, në kuptimin t'i bëni avokatinë në publik. Me këto të dhëna, nuk ju kupton dot njeri, fare.

Kolegët kanë të gjithë vështirësi të kuptojnë se çfarë ka qenë kjo dhe çfarë ka qenë ajo. Megjithatë, s'ka gjë, ecim përpara.

A ka ndonjë diskutim tjetër? Nuk ka.

Për pjesën nen për nen nuk ka ndonjë gjë, sepse është pjesë shumë e shkurtër dhe është vetëm pjesë formale.

Propozoj ta votojmë në parim këtë projektligj.

Kush është dakord në parim me projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes se huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale"?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1.

Kush është dakord?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 që flet për hyrjen në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi.

Faleminderit të ftuarve!

Stafi të ketë parasysh se menjëherë pas hapjes së sesionit të shtatorit, së bashku me dëgjuesat e tjera që do të parashikojmë në kalendar, do të jetë me prioritet kjo çështje.

Faleminderit të gjithë kolegëve!

Pushime të mbara!

MBYLLET MBLEDHJA